

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti:	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
Programi studimor:	Menaxhim në agrobiznes
Titulli i lëndës:	Metodologjia e kërkimit shkencor
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative (O)
Viti i studimeve/semestri:	Viti 1 / Semestri 1
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Do të shpallet
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Bekim Gashi
Detajet kontaktuese:	bekim.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Përmbajtja e këtij kursi përfshin metodat, teknikat, instrumentet dhe proceset e zhvillimit të kërkimit shkencor në fushën e agrobiznesit. Kursi i ofron studentëve bazën e njohurive teorike dhe shkathtësive praktike të punës shkencore. Kursi përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përfshin hyrjen e përgjithshme në metodologjinë e kërkimit shkencor, duke përfshirë temat mbi parimet e shkencës dhe kërkimin shkencor dhe konceptet themelore të punës krijuese shkencore. Pjesa e dytë përqendrohet në logjikën e zbatimit të punës shkencore, përpunimin e modelit të kërkimit, metodat e hulumtimit dhe teknikat e punës kërkimore shkencore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Objektivi kryesor i kësaj lënde është të zhvillojë orientimin kërkimor/hulumtues të studentëve dhe t'i njohë ata me bazat e metodave të kërkimit shkencor. Në mënyrë të veçantë, kursi synon t'i njohë ata me konceptet dhe parimet e përdorura në kërkime shkencore dhe me metodat e hulumtimit të biznesit dhe qasjen e tyre. Kursi përfshinë diskutimet mbi teknikat e marrjes së mostrave, modelet kërkimore dhe teknikat e analizës.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptojnë natyrën e kërkimit shkencor dhe metodologjisë kërkimore. ▪ Zhvillojnë kuptimin e modeleve dhe teknikave të ndryshme kërkimore. ▪ Zhvillojnë hipoteza, testime; pranimin, refuzimin dhe riformulimin. ▪ Zbatojnë teknikat e duhura sasiore për analizën e të dhënave eksperimentale dhe kërkimore. ▪ Zbatojnë qasje metodologjike për mbledhjen e të

	<p>dhënave; rolin e vrojtimit, eksperimentimit dhe deduktimit në agrobiznesi.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dizajnojnë dhe hartojnë forma të ndryshme të materialeve, dokumenteve, punimeve me karakter shkencor dhe profesional. ▪ Zhvillojnë kuptimin e dimensioneve etike të zhvillimit të kërkimit shkencor. ▪ Kuptojnë rolin e metodave shkencore në zhvillimin dhe avancimin e agrobiznesit dhe industrive të ndërlidhura. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	13	39
Ushtrime teorike/laboratorike	2	13	26
Punë praktike	1	3	3
Kontaktet me mësimdhënësin (konsultimet)	1	15	15
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokviume, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	8	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet etj.	3	1	3
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provimi përfundimtar.		
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 5%, Punimi i detyrave të shtëpisë: 10% Provimi i ndërmjëmë (kollokviumi): 15%, Projekti (punimi) i kursit: 20%, Provimi final: 50%,		
Literatura bazë:	<p>Creswell, J.W. and Creswell, D.J. (2018). Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches. Sage Publications.</p> <p>Flick, U. (2020). Introducing Research Methodology: Thinking Your Way Through Your Research Project. Sage Publications.</p> <p>Jakupi, A. (2005). Metodologjia e punës shkencore kërkimore. Universiteti i Prishtinës.</p>		

Literatura shtesë:	<p>Flick, U. (2018). An Introduction in Qualitative Research. Sage Publications.</p> <p>Holmes, D., Moody, P. and Dine, D. (2016). Research Methods for the Biosciences. Oxford University Press, New York.</p> <p>Battersby, M. (2010). Is that a Fact? Broadview Press, Peterborough.</p> <p>Matthews, J.R. and Matthews, R.W. (1996). Successful Scientific Writing – A Step-by-Step Guide for the Biological and Medical Sciences. Cambridge University Press, New York.</p> <p>Lee, J.A. (2000). The Scientific Endeavour – A Primer on Scientific Principles and Practice. Addison Wesley Longman, San Francisco.</p> <p>Ruxton, G.D. and Colegrave, N. (2011). Experimental Design for the Life Sciences (Third Edition). Oxford University Press, New York.</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në metodologjinë e kërkimit shkencor
<i>Java e dytë:</i>	Përzgjedhja e një modeli kërkimor (Tre llojet e dizajnit kërkimor, Tre komponentët e përfshirë në një dizajn, Dizajnet kërkimore si botëkuptime, strategjia dhe metoda, Kriteret për zgjedhjen e një modeli kërkimor)
<i>Java e tretë:</i>	Rishikimi i literaturës (Tema kërkimore, Rishikimi i literaturës)
<i>Java e katërt:</i>	Përdorimi i teorisë (Përdorimi i teorisë sasiore, përdorimi i teorisë cilësore, përdorimi i teorisë së metodave mikse)
<i>Java e pestë:</i>	Shkrimi i strategjive dhe konsideratat etike (Shkrimi i propozimit, Shkrimi i ideve, Çështjet etike për t'u parashikuar)
<i>Java e gjashtë:</i>	Dizajni i kërkimit: Hyrja (Rëndësia e hyrjes, hyrjet cilësore, sasiore dhe të metodave mikse, Modeli i hyrjes)
<i>Java e shtatë:</i>	Deklarata e qëllimit (Rëndësia dhe kuptimi i deklaratës së qëllimit)
<i>Java e tetë:</i>	Provimi i ndërmjetëm
<i>Java e nëntë:</i>	Dizajni i kërkimit: Pyetjet kërkimore dhe hipotezat (Pyetjet kërkimore cilësore, Pyetjet dhe hipotezat kërkimore sasiore, Pyetjet dhe hipotezat kërkimore të metodave të përziera)
<i>Java e dhjetë:</i>	Dizajni i kërkimit: Metodave sasiore (Definimi i anketave dhe eksperimenteve, Pjesët përbërëse të një plani të

	metodës së vrojtimit, Pjesët përbërëse të një plani të metodës eksperimentale)
Java e njëmbëdhjetë:	Procedurat cilësore (Karakteristikat e kërkimit cilësor, Strategjitë e kërkimit, Roli i studiuesit, Procedurat e mbledhjes së të dhënave, Procedurat e regjistrimit të të dhënave)
Java e dymbëdhjetë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave (Analiza dhe interpretimi i të dhënave, Besueshmëria, Validiteti dhe përgjithësimi, Shkrimi cilësor)
Java e trembëdhjetë:	Procedurat e metodave të përziera (Pjesët përbërëse të procedurave të metodave mikse, Natyra e hulumtimit të metodave mikse, Llojet e strategjive të metodave të mikse dhe modelet vizuale, Procedurat e mbledhjes së të dhënave, Procedurat e analizës dhe vlerësimit të të dhënave, Struktura e prezantimit të raportit, Shembuj të procedurave të metodave të përziera)
Java e katërbëdhjetë:	Etika në kërkimin shkencor (Rëndësia e etikës së hulumtimit, Parimet etike, Konsiderata të tjera etike dhe ligjore, Konsideratat etike në kërkimin në internet)
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i punimeve kërkimore

Ushtrimet

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
Java e parë:	Shpërndarja e temave të projekteve seminarike.
Java e dytë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës parë të ligjëratave.
Java e tretë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dytë të ligjëratave.
Java e katërt:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tretë të ligjëratave.
Java e pestë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës katërt të ligjëratave.
Java e gjashtë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës pestë të ligjëratave.
Java e shtatë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës gjashtë të ligjëratave.
Java e tetë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës shtatë të ligjëratave.
Java e nëntë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tetë të ligjëratave.
Java e dhjetë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës nëntë të ligjëratave.
Java e njëmbëdhjetë:	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dhjetë të ligjëratave.

<i>Java e dybëdhjetë:</i>	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës njëbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dybëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës trembëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës. ▪ Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm. ▪ Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare, ▪ Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studentit duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësuesi. ▪ Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve. 	